



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, “PËR BUXHETIN
E VITIT 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet. si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	407 205 milionë lekë;
- Fondi rezervë	16 200 milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000 milionë lekë;”.

2. Në paragrafin e fundit shuma “... 2 000 milionë lekë ...” zëvendësohet me “... 1 000 milionë lekë ...”.

3. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 2

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon;

“Neni 14

Fondi rezervë i buxhetit prej 16 200 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, si më poshtë vijon:

- 1 700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
- 13 500 milionë lekë si kontingjencë për paketën sociale antiCovid-19.
- 1 000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave antiCovid 19.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 3

Paragrafi i dytë, i nenit 15, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Përyjashtimisht për vitin 2020, kriterëve të shpërndarjes së fondit rezervë i shtohen edhe shpenzimet për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe programi për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Shuma e garancisë së qeverisjes qendrore “... 11 500 milionë lekë ...” zëvendësohet me “... 26 500 milionë lekë ...”.
2. Stoku i borxhit publik “... 1 197 139 milionë lekë ...” zëvendësohet me “... 1 212 139 milionë lekë ...”.

3. Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore “... 1 143 039 milionë lekë ...” zëvendësohet me “... 1 158 036 milionë lekë ...”.

Neni 5

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ